Numër: 01-215 Datë: 31.03.2026

Në mbështetje të neneve 6,8,9 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Rregulloren Nr. 01/196 e punës së Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë: 31.03.2026 merr:

V E N D I M

I. **Nuk akreditohet** kualifikimi **Ndihmës Kuzhinier,** niveli III i KKK i Qendrës për Aftësim Profesional QAP – Ferizaj. Adresa: Rr. "Liman Reka", Ferizaj, 50000.

II. Ndalohet regjistrimi i kandidatëve në këtë program deri në akreditimin e programit.

III. Institucioni mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Institucioni Qendra e Aftesimit Profesional – QAP Ferizaj. Adresa: Rr. "Liman Reka" Ferizaj brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë për akreditimin dhe validimin e kualifikimit **Ndihmës Kuzhinier,** NIVELI III I KKK.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) pas pranimit dhe shqyrtimit të aplikacionit, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ka caktuar ekipet e eksperteve të jashtëm me qëllim të vlerësimit të institucionit lidhur me përmbushjen e kritereve për akreditim dhe validim për kualifikimet si më lartë.

Ekipi i ekspertëve pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit 04.08.2025 për kualifikimin: **Ndihmës Kuzhinier.** Niveli **III** ndërsa vizita është realizuar me datën 06.08.2025. Pas përfundimit të procesit vlerësues, raportet janë realizuar me datë 03.09.2025.

Pas pranimit te raportit vlerësues të ekipit të ekspertëve dhe të gjeturat e evidentuara nga vizita në institucion, të dhënat janë proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 31.03.2026.

Sipas raportit të ekspertëve Kualifikimi **Ndihmës Kuzhinier,** niveli III i KKK i Qendrës për Aftësim Profesional QAP – Ferizaj, nuk arrinë të përmbushë standardet për akreditim të këtij kualifikimi. Aplikimi i institucionit vlerësohet si i paplotësuar për shkak të mospërputhjes kritike të strukturës kredituese me orët mësimore dhe mungesës së stafit me kualifikim adekuat profesional në fushën e gastronomisë.

Raporti specifikuar, citim:"

- ***Mospërputhje në strukturën kredituese**: Kurrikula përmban 310 orë mësimore dhe 17 kredi AAP. Sipas standardit të AKK, 1 kredi = 20 orë, që do të thotë se për 17 kredi duhen 340 orë. **Kushti i rekomanduar**: Për të përmbushur këtë mospërputhje, rekomandohet shtimi i **30 orëve në komponentin e vetëstudimit**, në mënyrë që totali i orëve të përputhet me numrin e kredive të përcaktuara. Pra, kushti kryesor i vendosur nga ekipi i ekspertëve lidhet me **harmonizimin e kredive me orët e planifikuara**, duke e bërë kualifikimin të përputhshëm me standardet e AKK-së dhe të krahasueshëm në nivel kombëtar e ndërkombëtar."*
- **Pamjaftueshmëria e infrastrukturës** (mungesa e ndarjes teori-praktikë) dhe mangësitë në rregulloret për transferimin e kredive dhe vlerësimin e kandidatëve me aftësi të kufizuara, e bëjnë programin të papajtueshëm me standardet e kërkuara të AKK-së.
  Infrastruktura aktuale ka mangësi funksionale, pasi mungon ndarja e qartë midis hapësirës për mësim teorik dhe asaj praktike, gjë që dëmton cilësinë e procesit mësimor.

- **Burimeve njerëzore:** stafi i propozuar nuk ka kualifikime të drejtpërdrejta në gastronomi, duke sqaruar në raport si mangesi, faktin se:
  - *Z. Adnan Islami është i diplomuar në Menaxhment dhe Informatikë (BSc), një fushë që nuk lidhet drejtpërdrejt me kualifikimin profesional të propozuar;*
  - *Znj. Erodita Tatlixhi ka përfunduar studimet në Teknologji Ushqimi (Bachelor) dhe vijon Master në Inxhinieri Ushqimore, por është e përfshirë vetëm si trajner shtesë, me dokumentacion të kufizuar në aktin e emërimit për mësim teorik (online dhe fizik), si dhe*
  - ***Vërejtje shtesë:** Nuk ka dëshmi se si znj. Tatlixhi do të angazhohet në Qendrën Trajnuese në Ferizaj, meqenëse është punëtore e rregullt në Pejë.*

- **Infrastruktura mësimore:** Mungon ndarja e qartë ndërmjet hapësirave për mësim teorik dhe praktik brenda kabinetit të kuzhinës, gjë që mund të ndikojë negativisht në cilësinë e procesit mësimor. **Kërkohet ndarje funksionale dhe e dokumentuar.**
- **Rregullorja për transferimin e kredive:** Rregullorja ka nevojë për më shumë detaje mbi procedurat praktike, dokumentacionin e nevojshëm, rolet institucionale, afatet kohore dhe të drejtat e kandidatëve, përfshirë informimin, transparencën dhe të drejtën e apelimit.
- **Rregullorja për kandidatë me aftësi të kufizuara:** Mungon përshkrimi i procedurave për vlerësimin fillestar të kandidatëve me aftësi të kufizuara (p.sh. instrumente konkrete për matjen e aftësive, teste diagnostike, analiza e nevojave individuale).

Pra nga ajo që u tha më lart ekipi i ekspertëve ka konstatuar se: Dokumentacioni i përgjithshëm, përfshirë Infrastrukturën mësimore, burimet njerëzore si dhe rregulloret për transferin e kredive dhe trajtimin e kandidatëve me aftësi të kufizuara, mbetet sipërfaqësor dhe i paplotësuar me procedura praktike apo mjete konkrete të vlerësimit.

Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve janë mbështetur në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit si: aplikacionet për validim të kualifikimeve, aplikacionet për akreditim të institucionit, raportin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni si dhe të gjeturave me rastin e realizimit të vizitave së realizuar tek pala aplikuese.

AKK bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr/03/L-060 Për Kualifikimet Kombëtare dhe nenin 23 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë është e obliguar të realizoj procesin e monitorimit dhe të raportoj tek Këshilli Drejtues i AKK-së.

Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së, referuar dispozitave ligjore, rekomandimeve të ekipit të ekspertëve të dhëna në raportet vlerësuese përfundimtare për akreditim dhe validim të institucionit aplikues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD së AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.*

Dr. Besim Mustafa
Kryetar i Këshillit Drejtues
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve

Vendimi u dërgohet:

- Institucioni Qendra për Aftësim Profesional QAP – Ferizaj
- Arkivit të AKK.